

Ejani!

一起来



SPECIALE

Ky është Pekini

Një ditë e përkryer në Londër

Aventura në Rio

UDHËTAR

Shqipëria në syrin e një kinezi

Sofra e kulturës

Poezi kineze

Mbi CRI SHQIP

Dua një jetë të gjelbër!



"Ejani" Botimi i CRI•SHQIP

DREJTORE

Qu Ning

AUTORË

Du Tuanwen
Liu Chengpeng
Jiang Lei
Wang Xianya
Zhan Dian
Zhang Yan
Zhang Zhuo

REDAKTORË

Albana Aliaj
Artan Goga
Ardi Pulaj
Leftion Peristeri

KOORDINATORË

Wang Xianya
Zhan Dian

DIZENJIMI

Çelësi
Design & Publicity

FOTOGRAFIA

Yang Yongpeng

PËRMBAJTJA

1. **Parathënie**
2. **Speciale**
 - a) Ky është Pekini
 - b) Një ditë e përkryer në Londër
 - c) Aventura në Rio
3. **Udhëtar**
Shqipëria në syrin e një kinezi
4. **Sofra e kulturës**
Poezi kineze nga Li Bai
5. **Mbi CRI SHQIP**

TEL

+86-10-6889-2306

E-MAIL

alb@cri.com.cn

ADRESA

Nr.16, Rruga Shijingshan
Pekin, Kina
100040

albanian.cri.cn



CIBN

CRJ

CHINA RADIO INTERNATIONAL
中國國際廣播電台



albanian.cri.cn



Me rastin e fillimit të botimit të Revistës së re me titullin shumë të bukur “Ejani”, dua në radhë të parë t’ju përshëndes për këtë iniciativë dhe t’ju uroj suksese në këtë ndërmarrje tuajën.

Stafit tuaj i shpreh falenderimet dhe vlerësimet më të mira për kontributin e madh që ka dhënë në njohjen e prezantimin tek lexuesit shqiptar e kinez të historisë, kulturës, lajmeve e çdo zhvillimi që ka ndodhur në të dy vendet tona.

Le t’i shërbejë edhe kjo revistë e re këtij qëllimi fisnik.

Titulli i revistës është shumë i bukur dhe me shumë kuptim. Ju i ftoni lexuesit të vijnë dhe të shohin ndryshimet kolosale të vendit tuaj të bukur, të marrin prej këtej por edhe të sjellin këtu eksperiencat të cilat do t’u vlejnin në të ardhmen.

Uroj që Revista, me rubrikat e saj, të rrisë gjithnjë e më shumë numrin e lexuesve dhe kjo t’i shërbejë më mirë rritjes dhe fuqizimit të marrëdhënieve miqësore tradicionale që fatmirësisht ekzistojnë në mes dy popujve tanë dhe dy vendeve tona. Edhe një herë ju përshëndes dhe ju uroj: “Dalshi faqebardhë”.

Kujtim Xhani

Ambasadori i Republikës së Shqipërisë në RP të Kinës

Ky është Pekini



Qindra vjet më parë, Pekini u ndërtua për të shpërfaqur idealin më të lartë të Perandorisë Kineze. Tani, struktura e qytetit me drejtim veri-jug dhe lindje-perëndim nuk e shpërfaq aq qartë të kaluarën perandorake, por ende gjenden gjurmët e një pjesë integrale të teorive të fengshui-t dhe bagua-së. Si një kryeqytet perandorak për 800 vjet, funksionet e Pekinit për të treguar idealet morale dhe humaniste janë më të dukshme se funksionet e banimit.

Ndoshta tani Pekini nuk është qyteti më i përshtatshëm për të banuar.

Që nga lashtësia e deri më sot, Pekini ka qenë djepi i një ideologjie të rëndësishme. Ndër të gjitha qytetet e Kinës, ndoshta më idealistët mbledhen në Pekin. Në fakt, në këtë qytet shumica e banorëve mbi 30-vjeçarë që kanë arsim të mesëm, dëshirojnë të thonë se janë idealistë. Por shumica e tyre janë të vetëdijshëm, madje realistë. Natyrisht, tani idealizmi mund të jetë vetëm një parullë, mund të jetë veprimi konkret dhe një ndjenjë, mund të jetë edhe gjest kundër dëshirës për t'u pasuruar...

Mirëpo, në këtë qytet të paktën fjala “idealizëm” mund të përmendet: në masë të konsiderueshme, një grup njerëzish kujdesen për ngritjen e cilësive morale.

Madhështia

Nëse do të na duhej të përshkruanim me një fjalë Pekinin, atëherë “madhështor” është më e përshtatshme. Rrugët, qielli, planimetria e qytetit, pallatet, peizazhi natyror; të gjitha këto krijojnë një atmosferë madhështore.



Pekini

Pekini, kryeqyteti i Kinës, është qyteti me bazat më të shumta kërkimore- shkencore, por edhe me arsimin më të zhvilluar në Kinë.

Si qendra e shkëmbimeve me botën e jashtme në shumë fusha, si politike, kulturore, ekonomiko-tregtare etj. Pekini është më tërheqës për elitën në krahasim me qytetet e tjera, si dhe nxit kultivimin e njerëzve të aftë.



sendet arkeologjike

Koha e lirë



akrobaci

Pekinasit janë kryesisht njerëz të ngeshëm. Ata ose të huajt që vijnë në Pekin mund të takohen shpesh nëpër bulevarde apo parqe, pika turistike etj. Gjatë pushimeve apo fundjavës, pekinasit pëlqejnë të dalin me familjen dhe miqtë për të pirë diçka apo për të ngrënë në restorante, ose edhe të luajnë me letra. Megjithatë, përveç këtyre ata janë edhe shumë të dhënë pas veprimtarive sportive. Historia dhe kultura e pasur kanë kultivuar një atmosferë të theksuar kulturore në Pekin, i cili është qyteti që ka numrin më të madh të trashëgimive kulturore në botë.

Pekini, qyteti me zhvillimin më të shpejtë në histori, po tërheq një numër gjithnjë e më të madh të huajsh, si për turizëm, ashtu edhe për të jetuar.

Bisedat


Pekinasit janë dijetarë e njohës të mirë të shumë fushave të ndryshme. Nëse bisedon me ta, tema e bisedës mund të jetë gjithëpërfshirëse, si për uebsajtet e ndryshme, futbollin, marrëdhëniet ndërkombëtare, madje mund të prekë edhe lëvizjet e personazheve publike në skenën politike të Kinës.



Kur flet me pekinasit, ata janë shumë kompetentë në atë që thonë, të duket sikur po diskuton me një profesor apo specialist të fushës përkatëse. Sidomos taksistët në Pekin janë shumë të dhënë



pas bisedave me klientët e tyre. Ata janë njohës mjaft të mirë të realitetit dhe të ngjarjeve të përditshme.




Vjeshta

Stina më e bukur në Pekin

Është një zgjedhje e mirë që ta vizitoni Pekinin gjatë vjeshtës. Edhe në kohën e lashtë perandorët dhe banorët e thjeshtë e dinin përafërsisht se si do të ishte moti në Pekin: stuhi me rërë në pranverë, zagushi në verë, i ftohtë i acartë në dimër. Vetëm vjeshta është e freskët në Pekin; as vapë, as ftohtë. Në këtë kohë, gjethet janë me ngjyrë të verdhë. Do të shihni një pamje të bukur, sidomos kur gjethet bien rreth mureve të oborreve në këtë qytet.

Ndoshta për arsye se ofrohen të gjitha kushtet, vjeshta e Pekinit duket më tërheqëse se në vendet e tjera. Një qytet me kohë të freskët, kulturë të lashtë e ndërtime moderne, është vendi i duhur për ta vizituar. Një udhëtim i mbushur me dashuri është i paharrueshëm, aq më tepër kur një qytet si Pekini, të ofron diçka të tillë.



Muri i Madh Kinez

Muri i Madh Kinez, me një gjatësi prej afro 10 mijë kilometrash, nis nga Shanhaiguani i qytetit Qinhuangdao të provincës Hebei dhe përfundon në perëndim, në Jiayuguan të provincës Gansu. Pjesa e Murit të Madh në Pekin ka një gjatësi mbi 600 kilometra dhe është ndërtuar kryesisht rreth vitit 1540. Segmenti i Murit të Madh që është ndërtuar në dinastinë Ming, ka një histori 450-vjeçare. Pjesët më të njohura të Murit të Madh janë Badaling, Jinshanling, Mutianyu, Juyongguang, Jankou etj. Në

të vërtetë, Pekini si një qytet i lashtë duhet ta falënderojë një burrë. Ai është perandori i parë i dinastisë Qin Yin Zheng.

Ky perandor i parë, ndonëse tiran, kishte njëfarë përgjegjësie për popullin e vet. Ndërtimi i Murit të Madh është një shembull i mirë. Muri i Madh luante në atë kohë një rol mbrojtës kundër agresorëve të huaj, prandaj edhe deri në dinastinë Ming perandorët vazhduan ta ndërtonin. Më vonë Muri nuk mundi t'u rezistonte agresorëve të huaj.



Muri i madh është ndërtuar para 2 mijë vjetësh për të kundërshtuar agresionin, por tani 8 për qind të tij ekzistojnë




Iker Casillas dhe Sara Carbonero




Iker Casillas dhe Sara Carbonero



Muri i madh në dimër



Pjesa e Murit të madh Jiankou është në formë harku dhe është më tatëpjete



Aktivitetet një orë në tokë 2012 në Murin e madh




Pjesa e Murit të madh të dinastisë Hane në Yumenguan të provincës Gansu



Kanali në Pallatin e Dimrit



Porta Wumen



Ndërtesë në një nga
qoshet e oborrit

Pallati i Dimrit

Nuk mund të hyni në “detin” Zhongnanhai, por mund të vizitoni Pallatin e Dimrit. Në qytetin perandorak, pasi të shihni këtë oborr gjigant ku jetonin dhe punonin perandorët e lashtë, do të ndieni ritmin e jetës së Pekinasve dhe kulturën e tyre. Për të njohur Pekinin, duhet patjetër ta nisni udhëtimin tuaj nga Pallati i Dimrit.

Pallati i Dimrit ndodhet në zemër të Pekinit. Quhet edhe “Qyteti i ndaluar” dhe tani është kthyer në një muze. Ai ka qenë pallati perandorak i dinastitë Min dhe Qing (1368-1912) dhe në të kanë jetuar 24 perandorë. Ndërtesat janë vepra madhështore arkitekturore dhe janë ndërtesat më të mëdha prej druri në botë. Në Pallatin e Dimrit ka 9999 ndërtesa. Për shkak se numri i ndërtesave të tij nuk mund ta kalojë atë të Perëndisë së Qiellit, që sipas legjendës kishte 10 mijë ndërtesa, numri u përcaktua të jetë nën 10 mijë.



Orë që përdorej në
lashtësi



Festime në sheshin Tienanmen


Sheshi Tienanmen

Sheshi “Tienanmen” është simboli i Pekinit dhe i gjithë Kinës. Ky shesh me histori 500-vjeçare mbetet ende më i madhi në botë. Ai jo vetëm është dëshmi e luftërave të shumta të popullit kinez për liri e demokraci, kundër pushtimeve të huaja, por është edhe vendi i shenjtë për zhvillimin e ceremonive madhështore dhe për pritjen e mysafirëve të huaj.

Të gjithë ata që vijnë në Pekin, sigurisht që nuk mund të lënë pa vizituar sheshin “Tienanmen”. Vizita e turistëve në Pekin nuk mund të quhet e plotë nëse nuk bëjnë një fotografi me portretin e kryetarit Mao Ce Dun në sheshin “Tienanmen”.



Tempulli i Qiellit



Tempulli i Qiellit në Pekin është një nga komplekset më të mëdha të ndërtesave të lashta për nderimin e zotave në botë.

Në Kinë ceremonia për nderimin e zotave fillon nga dinastia Zhou. Që nga dinastia Han, perandorët e dinastive të ndryshme i kushtuan shumë rëndësi kësaj ceremonie. Pas periudhës Yongle të dinastisë Ming, në çdo ditë të rëndësishme perandorët vinin këtu për të organizuar ceremoni për nderimin e zotave dhe për të uruar për korrije të bollshme. Në qoftë se koha ishte e thatë, organizoheshin dhe ceremoni



Pjesa e brendshme



Qytetarët bëjnë stërvitje në parkun Tiantan



Tullat e lashta në ngjyrë gri në parkun e tempullit Tiantan



Dimër në tempullin Tiantan



Marka e cigares "Tempulli Tiantan" në vitet 20 të shekullit të 20-të

lutjeje për rënien e shiut.

Koncepti kryesor i projektimit të ndërtesave të Tempulli të Qiellit është dallimi i gjerësisë dhe i lartësisë së qiellit, për të treguar madhësinë e zotave dhe vogëlsinë e njeriut.

Tempulli i Qiellit shpërfaq kudo edhe konceptin e simbolikën e kulturës tradicionale kineze. Muri i tempullit, që është i rrumbullakët në veri dhe katror në jug, dhe ndërtesa e rrumbullakët me murin e jashtëm katror, simbolizojnë konceptin e kozmologjisë tradicionale kineze të "qiellit të rrumbullakët dhe tokës katrore".

Po të mos vish këtu, nuk mund ta njohësh plotësisht qytetin perandorak.

Pallati i Verës



Hieroglifi kinez i çajit

Pallati i Verës, si qendra më e rëndësishme politike dhe diplomatike gjatë dinastisë Qing, i vendosur jashtë “Qytetit të ndaluar”, ka përjetuar shumë ngjarje historike. Perandoresha Ci Si ishte një pacifiste dhe meritat e saj mund të krahasohen me Ying Zheng, perandori i dinastisë Qin të Kinës së lashtë. Ajo shpenzoi fonde shumë të mëdha për të krijuar një kopsht gjigant.

Pallati i Verës ka një sipërfaqe prej afro 290 hektarësh dhe ndahet në disa pjesë, si zona e aktiviteteve politike, zona e jetës së përditshme perandorake, zona turistike me malin Wanshou dhe liqenin Kunming. Turistët mund të ngjiten në malin Wanshou, të vizitojnë ndërtesën me figurat budiste, ose të vozisin në liqenin Kunming. Në digën

lindore të liqenit mund të shijoni legjendat për fatkeqësitë e shkaktuara nga uji, të shihni lopë bronz, e pastaj të pushoni në korridorin më të gjatë i përfshirë edhe në librin e rekordeve “Gines” e të bisedoni me miqtë. Argëtimi perandorak ishte i tillë.



Peshq

Ndërtesa me
figura budiste





Legjenda tradicionale kineze



Julian praktikon Kungfunë




Lopë në bronz



Korridor i gjatë



Pallati i Verës



Kostumi i kuq i nuses



Lëndina e lotusve

Houhai dhe

Bluzë me Obamën



Nanluoguxiang,
Hutongu më i njohur i Pekinit



Nanluoguxiang



Restorant me
specialitete
shtëpie



Picë me karakteristika kineze



Hutongët lidhen ngushtë me kulturën vendore të Pekinit dhe janë përshkruar në veprat e panumërta të njerëzve të njohur, si Kang Youwei, Liang Qichao, apo shkrimtarë si Lu Sun,

Lao She, piktori Xu Beihong etj. Merrni një hartë të veçantë për hutongët dhe gjithashtu merrni me qira një biçikletë. Lëvizni ngadalë në këto lagje të vogla, duke parë jetën e përditshme të banorëve me historinë e Pekinit dhe shijimin e jetës.

Nëse do të vizitoni hutongët e Pekinit, ju duhet një biçikletë, pasi kështu mund të ndieni freskinë e vjeshtës dhe të shihni nga afër jetën e pekinasve. Mund të hani në restorantet e hutongëve, ku gjithnjë do të gjeni ushqime tipike pekinase. Ato janë edhe më të shijshme se në Wangfujing.

Hutongët



Biçikleta me qera



Jetë Nate

Distrikti i artit

Si ndiheni kur shihni që në një uzinë të braktisur pjesërisht banojnë shumë artistë flokëgjatë?

Këtu mund të shihni se si pranë tubave të mëdhenj prej çimentoje gjenden statuja nudo; mund të shihni punëtorët me rrobat plot vaj makine duke kaluar para bareve moderne; mund të shihni tabelat e rrugëve ku shënohen së bashku numrat e reparteve të fabrikës dhe emrat e lloj-lloj punishteve artistike. Këtu pasqyrohet thelbi i artit.

798







Parku “Beihai”

Pekini duket si një qytet ku mungojnë burimet ujore, por, në të vërtetë, brenda zonës së vjetër të qytetit gjenden disa liqene të mëdha, ndër të cilat ai i parkut “Beihai” është më i bukur i që të krijon përshtypjen e një liqeni me ujëra pa skaj. Këtu mund të shijoni edhe bukurinë e kopshteve të stilit të viseve në jug të lumit Jance, si edhe madhësinë e ndërtesave



perandorake. Në liqenin Beihai mund të bëni patinazh në akull në dimër dhe të udhëtoni me barkë në stinët e tjera. Ai është një vend ku mund të shijoni jo vetëm bukurinë natyrore, por edhe veprat e mrekullueshme artistike të krijuara nga dora e njeriut, si Muri “Jiulong” (mur i zbukuruar me një basoreliev që paraqet 9 dragoj) etj.



Basorelievi i budave në parkun "Beihai"



Dragoi është simboli i kombit kinez




Një turiste e vogël duke bërë fotografi me qipao, fustan tradicional kinez





Tempulli i Lamës



Tempulli i Lamës është tempulli më i madh dhe i ruajtur më mirë i Sektit të Verdhë të lamaizmit.

Në ndërtesat e këtushme unike ndërthuren karakteristikat e arkitekturave të ndryshme të kombësisë hane, mançure, mongole, tibetiane etj. Në këtë tempull ende banojnë mjaft murgj.

Gjatë rrugës drejt tempullit mund të nuhatësh erën e fortë të temjanit. Me të shkelur në bulevardin pas hyrjes, mund të ndieni qetësi të plotë shpirtërore. Buda gjigante në pallatin kryesor është një kryevepër mahnitëse artistike. Për njerëzit që kanë nevojë të gjejnë mbështetje shpirtërore, tempulli është një vend shumë i mirë, sepse lutjet e tyre shpesh realizohen. Kështu që tempulli pret përditë shumë vizitorë, sidomos në ditën e parë dhe të pesëmbëdhjetë të çdo muaji sipas kalendarit kinez, të cilat vlerësohen si ditët për të kryer ritet fetare budiste.



Ceremoni fetare në pallat



Turistë në tempull



Një lame në tempull



Kafshët mitologjike mbi strehët e çatisë besohet se largojnë shpirtrat e këqija



Besimtarë duke u lutur në Tempullin e Lamës



Luanët prej guri shihen shpesh në ndërtesat e lashta kineze

SPECIALE



Një ditë e përkryer në **Londër**



David Beckham me pishtarin e lojgrave olimpike



N ë qoftë se një njeri është i lodhur nga Londra, ai është i lodhur nga jeta,” ka thënë dr. Samuel Xhonsoni, njeriu më i njohur i letrave në Anglinë e shekullit të 18-të. Klishe, por e vërtetë: Londra është jeta. Është jeta e parqeve, e rrugëve dhe e sporteve; është jeta e qetë, jeta vetjake dhe jeta publike; është jeta bimore, jeta shtazore dhe jeta njerëzore e të tëra ngjyrave, besimeve dhe gjuhëve. E nëse do të provosh qoftë edhe një pjesë të vogël të kësaj jete në një ditë, të duhen plot energji – dhe një zgjim shumë i hershëm.



Rrugët e Londrës



Kabinat e Telefonit në Londër



London Underground metro



Mëngjes në Londër

T ë parët londinezë që zgjohen nga gjumi, janë shitësit në tregun “Borough” më shumë se shtatëshekulor; fundjavëve, buzëhollët dynden për bukë, djathra dhe mish gjahu, por gjatë ditëve të javës këtu gumëzhonjë tregtarët e shumicës të frutave e perimeve nga ora 02:00 deri në 08:00 të mëngjesit. Bashkojuni shitësve shëtites teksa shuanjë etjen në pabin “Market Porter”, i cili hapet që në 6:00 të mëngjesit.

Gjallërohuni me një shtim të kafeinës dhe me sillën e mëngjesit në kafenenë “Monmouth”, pastaj bëni për nga lindja, kaloni Urën e Kullës dhe admironi Kullën e Londrës të shekullit të 11-të.

Por nuk ka kohë për ta eksploruar këtë bastion norman. Në vend të kësaj, hipni në autobusin ujqor “Thames Clipper” që lundron drejt perëndimit për nga Kulla “Pier”.

Nga kuverta, shikoni me radhë lavditë arkitekturore dhe historike: “Monumentin” – përmendoren e Sër Christopher Wren-it për Zjarrin e Madh të 1666-s - pastaj arritjen tjetër të Wren-it, Katedralen e Shën-Palit. Majtas shquhen “Globi i Shekspirit” - një rikrijim i teatrit më të njohur të dramaturgut me famë botërore - dhe “Tate Modern”, hapësira hijerëndë e artit bashkëkohor, që shpalllos magjinë e vet buzë lumit, veçanërisht pasi bie muzgu.

MODERN TATE



Exhibition at Tate Modern



Market Porter



Inside the National Portrait Gallery



The Shakespeare's Globe Theatre
on London's South Bank,



Thames Clipper



Performances going on at the Shakespeare's Globe





Parlamenti

Paradite

Zbritni në “Waterloo Pier”, përballë madhështisë gotike të ndërtesës së Parlamentit dhe “Westminster Abbey”, një “fluturim” në rrotën e djallit më të madhe, “Syri i Londrës” në “Parkun e jubileut” në Bregun Lindor, ia vlen 30 minuta të çmuara të ditës suaj për një perspektivë të veçantë ajrore.

në Londër



Syri i Londrës



Taksitë dhe linjat Urbane tradicionale të Londrës



Hyrja e Palatit Buckingham



Brenda Muzeut Britanik



Sheshi Trafalgar

Brenda Palatit Buckingham



Përshkoni Urën e Jubileut të Artë - në anën lindore, që të shihni sërish pjesën e përshkruar në Tamiz – për të arritur në sheshin “Trafalgar”, zemra nga e cila përhapen arteriet e Londrës. Kolona e Nelsonit është pas jush; ndërsa në krahun tuaj të majtë “The Mall”, së bashku në pallatin “Buckingham”. Përpara është Galeria Kombëtare, streha e 2300 veprave të artit; ka hapësirë dhe është falas, kështu që përzgjidhni: shijoni qetësinë e “Kartonit” të Leonardo da Vincit.


Ecni në lindje nëpër “Covent Garden” dhe dredhojuni xhong-lerëve e shtatoreve njerëzore për të gjetur “Rock & Sole Plaice” për një drekë tradicionale britanike me peshk dhe patate të skuqura.



Ura Millenium për Katedralen St



Westminster Abbey Cloister



Westminster Abbey



Palati Buckingham



Mbrëmje në Londër

Nisni mbrëmjen me një koktejl në “Coburg Bar” (The Connaught, Carlos Place, Mayfair), një vend i mrekullueshëm dhe mikpritës.



Në Lindje është Soho, me restorantë orientale në Chinatown. Mos harroni të shkoni në “The Ivy” në 1-5, Rruga perëndimore, në Covent Garden. Duhet të rezervoni përpara.





Jeni në mes të vendit të teatrove, por mos humbisni edhe një vend të rëndësishëm të Londrës: Ronnie Scott's (47 Frith, Soho), shtëpia e muzikës së gjallë xhez për më shumë se 50 vjet. Nëse ende ju mbajnë këmbët shkoni në Lindje për disa klube nate: Cargo në 83 Rivington, Shoreditch, organizon festa me DJ të ndryshëm të muzikës elektro-nike.

Ka ende për maratonën tuaj 24 orëshe: Brick Lane Beigel Bake (159 Brick Lane, Spitalfields) ofron ushqime me proshutë viçi të kriposur, gjatë gjithë ditës. (Ardi Pula)



SPECIALE

Pak histori për

RIO' n

Rio de Zhaneiro është qyteti që është sot për shkak të së kaluarës së tij historike. Sundimtarët portugezë ishin të parët që sunduan në Rio që nga çasti kur zbarkuan në tokën e gjirit Guanabara më 1 janar të vitit 1502. Gjiri shtrihet në grykëderdhjen e një lumi, nga ku vjen dhe emri "Rio de Janeiro", që do të thotë "Lumi i Janarit". Francezët gjithashtu donin ta kthenin Rion në pozicionin strategjik më të mirë në rajonin Brazilian dhe u përpoqën të krijonin një bazë qendrimi në qytet, por u zbuhan nga qyteti pas dy vjetësh luftimi intensiv. Për t'u mbrojtur nga dyndjet e mëtejshme, qyteti u zhvendos në një pozicion të sigurt në një kodër, e cila më pas u quajt "Kodra e kështjellës".



Rio u zhvillua ekonomikisht duke vazhduar të kultivojë prodhimin e tij tradicional: kallamsheqerin. Më pas, në zonën e Minierave Gerais u gjet ar dhe diamant. Pas këtij zbulimi, shumë vende të tjera evropiane janë përpjekur për të pushtuar dhe fituar Rion. Në vitin 1763, kryeqyteti i rajonit u shndërrua nga Salvador në Rio.

Megjithatë, kjo rëndësi ekonomike nuk zgjati shumë. Sapo Rio hyri në shekullin e 19-të, prodhimi i kallamsheqerit u përball me konkurrencë të fortë nga vendet e tjera të Amerikës së Jugut dhe gjithashtu edhe rezervat e arit e diamanteve u ulën, duke e çuar Rion në rrugën e një krize ekonomike. Për të parandaluar këtë situatë Rio filloi të eksportojë kafe dhe familja mbretërore portugeze u rivendos në Rio. Kur portugezët u larguan, Brazili me në fund arriti pavarësinë e tij.

Kur Brazili arriti pavarësinë në vitin 1889, Rio u caktua kryeqytet. Me kalimin e viteve, Rio ka ndryshuar në aspektin e infrastrukturës dhe atë financiar. Qyteti u nda në tri zona. Zona e Veriut u bë një zonë industriale



dhe njëkohësisht në të ishte qendra e sektorit të punës, ndërsa zona e Jugut i përkiste vetëm njerëzve të pasur. Pas Luftës së Dytë Botërore, Rio u shndërrua nga një vend me ekonomi bujqësore

në një vend me ekonomi industriale. U ndërtuan ura në mes të qyteteve të rëndësishme, janë ndërtuar rrokaqiejt dhe autostradat m o r ë n z h v i l l i m .



Popullsia e qytetit është rritur në përmasa gjigante. Në fakt, Rio është një nga qytetet më të populluara në botë.

Në 1960-n, për të ulur presionin ekonomik dhe atë financiar në Rio, kryeqyteti i Brazilit u zhvendos nga Rio në Brazilias dhe më vonë në Sao Paolo. Pushteti politik u zhvendos



në brendësi të vendit. Sot Rio, edhe pse në përbërjen e tij mbart grupe të ndryshme etnike, është duke bërë të mundur të ndihet prania e tij në sektorin industrial, të shërbimeve dhe të turizmit. Kompani të mëdha shumëkombëshe kanë selitë e tyre në Rio, dhe qyteti ka ndikimin e tij në ekonominë braziliane, si një e tërë.

Aventura në Rio

Pak njerëz kanë në ditën e tyre tension e ngut në Rio-de-Zhaneiro – mbi të gjitha, ky është një qytet i njohur gjerësisht në të gjithë Brazilin si vendi që të fal paqe e aspak stres, si dhe jetesë të orientuar nga bregdeti. Këtu është vendi ku fjalët gëzimndjellëse “Boa Praia!” [Paçi plazh të mbarë!] dëgjohen rëndom të hënën si të ishte e shtunë. Rëndom turistët parapëlqejnë të veprojnë ashtu si vendasit, duke shijuar natyrën e diellit përvëlues të qytetit



Surf



Hedhje me deltaplan



Futboll



Alpinizëm



Rafting



Pylli
i
Shiut



Ura Niteroi



Statuja e Krishtit



Mali Corcovado



Mali i Sheqertë, Pylli i Shiut Tujica dhe Mali Corcovado

Rreth 600 milion vjet më parë, nëna natyrë krijoi gjeologjikisht një mrekulli natyrore, Pao de Acucar apo Copa e sheqerit. Nga shekulli i XVII portugezët rimorën kontrollin. Gjatë kësaj kohë e kallami i sheqerit përbënte eksportin kryesor, ku menjëherë pas përfundimit të procesit produkti përfundimtar paketohej në formën e bukës, ndaj edhe ky vend sot quhet mali i Sheqertë.

Për të mbërritur në majën malit të Sheqertë duhen dy faza. Së pari makina mund të ngjitet deri në lartësinë e 236 metrave në kodrën Urca ku të shfaqet një peizazh madhështor i malit Corcovado, urës Niteroi dhe gjirit Guanabara. Ngjitja tjetër me makinë shkon deri në majë në lartësinë 397 metra ku shfaqet peizazhi madhështor i Kopakabanës dhe nga ku mund të admirohen edhe plazhet përreth.

Duke ndërthurur dy shëtitje në Rio, mund të përfutosh një ekskursion ditor të mbushur me peizazhe që të lënë pa frymë.

Në mëngjes mund të shijosh panoramën e qytetit duke u ngjitur me teleferik në majën e Malit të Sheqertë.

Pas drekës, mund të udhëtoni me tren nëpër pyllin e shiut Tijuca për t'iu ngjitur më pas majës së malit Corcovado tek statuja e Krishtit Shëlbues.



Katedralja e Rio de Zhanejros



Fasada magjepsëse e Katedrales së Rio de Zhanejros u projektua nga arkitekti Edgar de Oliveira. Frymëzimi i tij lidhet me piramidat Maia në Meksikë.

Nga brenda katedralja ndizet nga rrezet e diellit që thyejnë dritaret e xhamta me ngjyra të gjalla që variojnë gjatë ditës me intensitet të ndryshëm. Secila nga



katër dritaret e bollshme iu ngjiten mureve dhe shkojnë deri në çati duke formuar një kryq nëse i shikoni drejt.

Dritaret ndryshojnë në formë dhe ngjyrë dhe krijojnë një atmosferë mistike, ndërsa struktura konike jep një akustikë të shkëlqyer duke u siguruar vizitorëve dëgjim kumbues kur priftërinjtë katolikë interpretojnë këngë hyjnore!



Plataforma Samba Show & Carnival



A snjë vizitë në Rio nuk mund të quhet e përfunduar pa përjetuar dhe ritmin e shfaqjeve shumëngjyreshe të sambës.

Mbrëmja mund të shijohet tek Plataforma Show ku ju do të argëtoheni nga balerinë dhe muzikantë të shkëlqyer, me mundësinë e shijimit të një banketi brazilian.

Karnavalet u paraqitën në Rio nga portugezët rreth vitit 1850.

Karnavalet në fillim ishin të paqytetëruara dhe nuk njiheshin nga qeveria braziliane. Pjesëmarrësit luanin në rrugë duke i hedhur njëri tjetrit ujë, baltë dhe ushqim.





Plazhi Copacabana

Copacabana

Plazhi më i famshëm në botë, Copacabana ka humbur gjatë viteve pak nga misteri dhe bukuria e tij. I vendosur në një mjedis mrekullisht të pasur me kodrat e mprehta që ngrihen mbi xhungël në sfond, Copacabana është vendi më i mirë për të ndierë frymën Carioca.

Uluni në një nga restorantet e shumtë përgjatë bregut për të shijuar një batida ose Caipirinha, ose bëni një shëtitje në trotuaret e famshme.

Verës shkoni herët pasi do të jetë e vështirë për të gjetur një vend në rërë. Gjithashtu, mbani parasysh se rrymat detare janë shumë të forta. Një vend i përkryer për të ngrënë, për të pirë dhe për t'u çlodhur duke parë njerëzit përreth.

Ipanema

Ky plazh i Rio-de-Zhanejros është aq i famshëm sa që ka edhe një këngë të titulluar “Vajza nga Ipanema” – por mbase plazhi është bërë i famshëm për shkak të këngës.

Valët përhapen nëpër rërë duke krijuar një mjedis jo të mirë për peshkim, por shumë të përshtatshëm për çdo veprimtari tjetër. Dy male të njohur si “Dy vëllezërit” lartësohen në fundin perëndimor të plazhit, të cilat i shtohen peizazhit të oqeanit me ujë të pastër.

Zakonisht në plazh luhet volejbolli ose futboll, ndërsa në pjesë të caktuara të ditës kur dallgët harkohen, këshillohet të bësh sërif.

Plazhi Ipanema



Artistet holandeze zbukurojnë qytetin e Rios

Agnieszka Chojaczyk 23 vjeç, (në të majtë) një studente shkëmbimi polake që ka jetuar në Rio për katër muaj, dhe Anne Lechowicz, 21 vjeç, (në të djathtë) franceze, edhe kjo studente shkëmbimi. Që të dyja kanë mësuar për projektin përmes internetit dhe vendosën që të vijnë dhe të admirojnë ngjyrat e Santa-Martës.

Imazhi mahnitës i ylberit që bie mbi lagjen e barakave Santa Marta të Rio-de-Zhanejros, formon një kryevepër spektakolare prodhim i dy artistëve. Të rinjtë vendas nga Favela e varfër Santa Marta ndihmuan Jeroen Koolhaas dhe Dre Urhahn, për të filmuar një dokumentar në lidhje me hip hop-n në komunitetet e barakave.

Dyshja holandeze, e njohur ndryshe edhe si Haas dhe Hahn, zgjodhi për të qëndruar këtu, ku filloi “maninë e pikturave të Favela”, një lëvizje për të sjellë veprat e artit në vende të paimagjinueshme. Shumë prej banorëve të zonës që janë rrethuar nga shkëlqimi i ngjyrave, thanë se jeta e tyre u pasurua duke jetuar mes artit

Rrobat e varura nëpër ballkone, pjesët e këmbimit të një biçiklete dhe fëmijët që luajnë mes këtij kaleidoskopi ngjyrash tregojnë se si jeta e përditshme është bërë shumë më e ndritur për banorët.



Shqipëria në syrin e një Kinezi



Shqipëria, një vend i vogël në zhvillim të vazhdueshëm e me shumë potenciale, gëzon një pozitë të favorshme gjeografike në Gadishullin Ballkanik. Megjithëse me një popullsi të vogël, banorët e saj janë të vetëdijshëm për mbrojtjen e mjedisit, duke ruajtur në përgjithësi një natyrë të virgjër. Shqipëria është zgjedhur një nga vendet më të mira për të kaluar pushimet në vitin 2011 nga disa gazeta të njohura. Disa të tjerë madje e kanë cilësuar atë si vendin ku Zoti “hodhi grimcën e fundit të rërës”.

Rrugët e qytetit janë të gjelbëruara, një simbol ky i historisë së lashtë. Në stinën e verës sigurisht shqiptarët dhe turistët e huaj vizitojnë plazhet e bukura dhe argëtohen. Objektet e trashëgimisë

kulturore, kështjella apo kisha të lashta gjenden kudo anembanë vendit. Të gjitha këto janë shenja të një civilizimi dhe kulture të lashtë.

Klimë mesdhetare, ajër i freskët dhe peizazh i bukur natyror.



Yang Yongpeng
(Profesori i Shkollës
së Radio-Filmit të
Universitetit të
Liaoning-ut)

Populli shqiptar, pas vuajtjeve të rënda të luftërave, shfaq një karakter të gjallë fisnik, që lë përshtypje të thellë te vizitorët e huaj.



Poezi nga **Li Bai**



Li Bai (李白) (701 e. s. – 762 e. s.) vlerësohet si një ndër tre poetët më të mirë të dinastisë Tang (618-907) dhe si poeti më i madh romantik kinez i të gjitha kohërave. Siç kanë vërejtur studiuesit, vetë jeta e këtij shpirti të trazuar, e këtij udhëtari të përhershëm që kurrë nuk gjente qetësi, u bë muza e tij. Po sjellim për lexuesit e revistës sonë një tufë poezish të shkurtra nga ky gjeni i poezisë klasike kineze.

Ndarje në një dyqan vere në Nankin
金陵酒肆留别

Era që sjell pushin e shelgjeve ëmbëlson dyqanin
风吹柳花满店香

Një vashë prej Vuje, tek shtie verë, më cyt që ta ndaj
吴姬压酒唤客尝

Me shokët nga qyteti që kanë ardhur të më përcjellin.
金陵子弟来相送

E ndërsa të tërë i zbrazin kupat, u them duke ikur:
欲行不行各尽觞

“Oh, shkoni pyesni lumin që rrjedh drejt lindjes,
请君试问东流水

Në mund të shkojë më larg se dashuri e mikut.”
别意与之谁短长

Ulem i vetëm në
malin Jingting
独坐敬亭山

Një trumbë zogish
fluturon tej,
众鸟高飞尽

Një re e vetmuar
endet përtace.
孤云独去闲

S'lodhemi kurrë sho-
shoqin së pari
相看两不厌

Veç unë dhe mali.
只有敬亭山

Pyetje dhe përgjigje në mal
山中问答

Më pyet përse rri në malin e blertë,
问余何意栖碧山

Buzëqesh e nuk gjegjem, se zemrën e kam të
lirë,
笑而不答心自闲

Lulet e pjeshkës i merr rrjedha e venë në
askund,
桃花流水杳然去

Bota ime prej të njerëzve është e ndarë.
别有天地非人间

Përktheu: Artan Goga



Mbi

CRI – SHQIP

Redaksia e shqipes e Radios së Jashtme të Kinës (**RJK**) nisi transmetimin e emisioneve në gjuhën shqipe 43 vjet më parë, më 6 qershor 1969.

Tani një program prej 60 minutash në gjuhën shqipe transmetohet me valë të mesme nga tokat shqiptare dhe mbulon tërë Shqipërinë. Njëkohësisht, jepen çdo ditë edhe 90 minuta programe në valë të shkurtra.

Uebsajti “**albanian.cri.cn**”, që filloi në dhjetor të vitit 2003 si pjesë e uebsajtit CRI Online (**www.cri.cn**), është një multimedia që integron lajmet, fotoreportazhet, audio-video dhe revistën në formë elektronike në një të tërë. Nëpërmjet faqeve të reja synojmë t’u shërbejmë më mirë përdoruesve shqiptarë të internetit, me informacione të pasura e thelbësore mbi ekonominë e kulturën kineze.

Edhe stafi ynë po pasurohet bashkë me zhvillimin e redaksisë. Tani ne kemi një grup të aftë të përbërë nga dhjetë punonjësish kinezë dhe katër shqiptarë, të cilët kërkojnë përsosje në punët e përditshme.

Nuk mund të mos përmendim këtu edhe dëgjuesit tanë. Ata janë jo vetëm miq, por na ndihmojnë dhe japin sugjerime në punën tonë. Çdo jehonë, propozim dhe koment nga dëgjuesit na tregojnë vlerën dhe rëndësinë e punës sonë dhe na jep forcë për t’iu përkushtuar me më shumë pasion kësaj pune dhe përgjegjësie të madhe.

Revista jonë “Ejani!” është platforma e re, nëpërmjet së cilës, shpresojmë t’u ofrojmë sa më shumë informacione dhe njohuri shqiptarëve që kanë interes të njohin Kinën, Shqipërinë dhe vende të tjera nga një perspektivë e veçantë.

Stafi

i Redaksisë
në Gjuhën **Shqipe**

albanian.cri.cn



CIBN

CRJ
CHINA RADIO INTERNATIONAL
中國國際廣播電台

